



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 14, datë 10/03/2004.

PËR
“STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE NIVELIN E PAGAVE TË QENDRËS
EKONOMIKE TË ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE”

Në mbështetje të Ligjit 8652, dt. 31/07/2000, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 10, pika 3/II, (gërma “c”), 11, pika 3, gërma “a” e 32, gërma “ç”, Ligjit Nr. 8487, date 13/05/1999 “Për kompetencat në caktimin e pagave të punës”, ndryshuar me Ligjin Nr. 8935, date 12/09/2002 “Për disa ndryshime në Ligjin 8487, datë 13/05/1999”, neni 3, gërma “d”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 551 datë 07/11/2002 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page, përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, pika 14, VKM-së Nr. 323, datë 14/06/1993 “Për kalimin e institucioneve fëmijore (çerdheve) në administrim të pushtetit lokal”, Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr. 1, datë 02/05/1995 “Për normat e vendosjes së personelit në çerdhe” pasi shqyrtoi Relacionin të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak.

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e bashkimit administrativ të Qendrës Ekonomike të Arsimit dhe të Qendrës Ekonomike të Çerdheve, duke krijuar Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Qytetit të Tiranës.
2. Në mbështetje të pikës 1 të këtij Vendimi, miratohet struktura organizative dhe numri i punonjësve (424), i Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Qytetit të Tiranës, sipas organigramës bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Qytetit të Tiranës do të jetë përgjegjëse për:
 - Administrimin ekonomiko-financiar të aktivitetit të kësaj qendre.

- Ndjekjen e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve të çerdheve e të sistemit parashkollor dhe shkollor.
 - Planifikimin, detajimin dhe ndjekjen e të gjithë treguesve ekonomik-financiar, të buxhetit, furnizimit me ushqim për çerdhet dhe sistemin parashkollor (kopshtet).
 - Planifikimin dhe ndjekjen e furnizimit me materiale konsumi për çerdhet dhe sistemin parashkollor dhe shkollor.
 - Organizimin dhe kryerjen e pagesave të punonjësve të sistemit parashkollor dhe shkollor në bazë të organikave të miratuar nga Drejtoria Arsimore, Tiranë.
 - Vjeljen e të ardhurave nga pagesat për kuotën e ushqimit të fëmijëve.
4. Miratimin e nivelit të pagave, të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Qytetit të Tiranës sipas Lidhjes Nr.5, bashkëlidhur këtij Vendimi.
 5. Ngarkohet Qendra Ekonomike e Arsimit, Qendra Ekonomike e Çerdheve, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të Qytetit të Tiranës, për të kryer inventarët dhe veprimet e nevojshme kontabile e financiare që lidhen me zbatimin e pikës 1, të këtij Vendimi.
 6. Zbatimi i pikës 1, 2 dhe 4 të këtij Vendimi, përfshirë dhe efektet financiare të tyre, do të fillojnë më datë 01/04/2004 dhe do të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2004.
 7. Të gjitha aktet dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë Vendim shfuqizohen.
 8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike në Bashkinë e Tiranës, si dhe Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Qendra Ekonomike e Çerdheve për zbatimin e këtij Vendimi.
 9. Ky Vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI